

V E N D I M
Nr.171, datë 18.4.1995

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.42, DATË 23.1.1995 “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” DHE TË LIGJIT NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 23.1.1995, në kreun II, paragrafi i parë, rreshti i parë, hiqet “neni 54”.

Në kreun II, pas paragrafit të dytë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në zbatim të nenit 54, pika nr.2 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, niveli bazë për vitin 1995 është 1920 lekë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi